



# Partia Demokratike

## PROJEKTREZOLUTË

Kryesia e Partisë Demokratike të Shqipërisë, mbledhur në datë 24 qershori 2024, i propozon për miratim Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, Projektrezolutën si më poshtë:

Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike, mbledhur sot më datë 28.06.2024,  
Pasi mori në shqyrtim situatën politike dhe shoqërore në Shqipëri, konstaton se:

- ✓ Shqipëria është duke kaluar një situatë shumë të rëndë ekonomike, shoqërore dhe politike, më të vështirën që pas përbësjes së regjimit totalitar në dhjetor të vitit 1990. Narkoshteti tashmë i instaluar në Shqipëri, ka asfiksuar thuatje çdo hapsirë të demokracisë politike dhe shoqërore, të lirisë së pronës dhe sipërmarrjes. Shteti ligjor është zëvendësuar me narkoshtetin;
- ✓ Krimi i organizuar sot kontrollon efektivisht qeverinë dhe politikëbërjen, ekzekutivin dhe legjislativin, nëpërmjet fenomenit të kapjes së shtetit. Narkoeurot, paratë e krimit të organizuar pastrohen haptazi nën kujdesin e qeverisë, veçanërisht në sektorin e ndërtimit. Në këmbim, më pas me to blihen vota për të mbajtur narkoshtetin në pushtet. Ky rrëth vicioz ka pamundësuar rotacionin normal politik, në dëm të Shqipërisë dhe shqiptarëve;
- ✓ Projekt “Shqipëria e shpopulluar - Shqipëria pa shqiptarë”, është goditja më e rëndë që i jepet Shqipërisë, kombit shqiptar pas rrënimit material dhe njerëzor që solli regjimi totalitar i Enver Hoxhës. Ideues dhe zbatues i këtij projekti kobzi është Edi Rama dhe pseudo mazhoranca e drejtuar prej tij. Ky projekt ka sjellë braktisjen masive në tetë vite, ku rrëth 1 milionë shqiptarë kanë braktisur Shqipërinë, duke rezultuar me shpopullimin më dramatik të vendit në tërë historinë e tij
- ✓ Pamundësia për të jetuar me punë të ndershme në një vend normal dhe mungesa e perspektivës, rritja galopante e taksave, çmimeve dhe shtrenjtimi i skajshëm i kostos së jetesës, rënia e prodhimit vendas, përkeqësimi i klimës së biznesit, dominimi i narkoerove në tregun monetar dhe zhbalancimi i fortë i kursit monetar të këmbimit, mungesa e konkurrueshmërisë, goditja e rëndë e sektorëve të ekonomisë si sektori i eksporteve, ai industrial dhe bujqësor, sistemi arsimor i shkatërruar dhe i politizuar në ekstrem, përqëndrimi i ekonomisë dhe burimeve kombëtare në duar të personave të lidhur drejtpërdrejtë me qeverinë dhe krimin, nëpërmjet PPP megakorructive,

grabitja e pronës dhe parave publike, të gjitha këto fenomene së bashku janë bashkëshoqërues të qeverisjes socialiste nën drejtimin e Edi Ramës;

✓ Drejtësia e re e reformuar, fillimisht e mbështetur nga i gjithë spektri politik, fatkeqësisht është kthyer në instrument politik për të goditur opozitën shqiptare dhe për të mbrojtur mazhorancën e megakorruptuar nga skandalet e panumërtë dhe të njëpasnjëshme;

✓ “**Shqipëria pa opozitë - asgjësimi i pluralizmit shqiptar**” është një tjetër projekt për të kthyer mbrapsht rrotën e historisë dhe gjunjëzuar shoqërinë shqiptare. Në tre vitet e fundit, opozita shqiptare ka përjetuar një agresion të paprecedentë. Lideri i opozitës, me ndihmën e “organeve të reformuar të drejtësisë së re”, mbahet i burgosur politik në shkelje flagrante të Kartës së të Drejtave të Njeriut, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të kompetencave të Kuvendit të Shqipërisë dhe kuadrit ligjor, pa asnje akuzë, pa asnje provë apo fakt, thjesht si person në hetim. Tejzgjatja e procesit gjyqësor për simbolet dhe flamurin e Partisë Demokratike u bë gjithashtu më qëllim për të goditur dhe dobësuar opozitën shqiptare. Në sajë të qëndresës së saj të pashëmbullt, të sakrificës së qindra mijëra demokratëve dhe opozitarëve, sot Partia Demokratike është e bashkuar nën flamurin dhe simbolet e saj dhe udhëheq opozitën shqiptare në përballje me narkoshtetin e instaluar në Shqipëri.

✓ Nën agresion ka qenë dhe mbetet familja shqiptare dhe vlerat e saj tradicionale. Kjo axhendë e imponuar nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, është “një mish i huaj vdekjeprurës” për familjen shqiptare, si bërrthama më e shëndetshme e shoqërisë shqiptare!

**Për këtë arsyë,**

**Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike  
deklaron se:**

- Partia Demokratike ka mision të saj shpëtimin e Shqipërisë nga narkoshteti, krimi i organizuar dhe megakorrupsioni. Shqipëria duhet t’i kthehet vlerave evropiane, shtetit të së drejtës, drejtësia së pavarur, ekonomisë së tregut, të drejtave themelore të lirisë së individit, qeverisjes së pastër dhe të përgjegjshme në integrimin e saj në Bashkimin European.
- Partia Demokratike ka gjithashtu mision të saj shpëtimin e familjes dhe shoqërisë shqiptare nga pseudovlerat që serviren në emër të ideologjive progresiste, të maskuara si kredo të së majtës globale moderne. Partia Demokratike beson se familja e shëndetshme është parakusht për një shoqëri të shëndetshme dhe se vlerat universale të familjes janë të shenjta dhe nuk mund të preken apo tjetërsohen.

- Bashkimi i opozitës nën flamurin e vlerave demokratike është tashmë realitet dhe prioritet absolut i Partisë Demokratike. Aksioni politik i Partisë Demokratike duhet të synojë jo vetëm bashkimin e demokratëve në një front të vetëm përballjeje me narkoshtetin, por bashkimin e të gjithë opozitarëve që qeverinë socialiste të Edi Ramës e konsiderojnë rrezik kombëtar dhe mendojnë se ky regjim duhet luftuar deri në fund dhe pa asnjë kompromis.
- Për të realizuar këtë mision kombëtar, Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike i bën thirrje strukturave drejtuese të Partisë Demokratike të marrin të gjitha masat dhe të përgatisin të gjitha kushtet për bashkimin e demokratëve dhe qytetarëve në një front të vetëm, duke lënë mënjanë çdo dallim apo mosdakordësi, sepse ajo që bashkon të gjithë opozitarët, rezistenca ndaj narkoshtetit dhe fitorja në zgjedhjet e ardhshme, janë prioritare.
- Partia Demokratike konsideron zgjedhjet e lira dhe të ndershme si mekanizëm thelbësor që garanton pluralizmin politik dhe vlerat e familjes evropiane ku duam të bëhem pjesë. Për këtë arsyе Partia Demokratike kërkon me forcë dhe do beje çdo përpjekje për një qeveri teknike, për të garantuar minimumin e standardeve të pranueshme zgjedhore, si parakusht për rotacionin politik që presin shqiptarët. Qeveria teknike dhe vota e diasporës janë kushtet më themelore për zgjedhje të lira dhe të ndershme në Shqipëri. Realizimi i tyre është detyrimi më madhor dhe më jetik i Partisë Demokratike dhe opozitës shqiptare.